



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 244

VENDIM

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 148, DATË 16.03.2021 “PËR CAKTIMIN E
VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V Ë R E N

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 148, datë 16 Mars 2021, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”, sipas lidhjes 1 të tij. Bazuar në listën e dërguar te objekteve nga Prefekti i qarkut Korçë, për VNV e KZAZ-së nr.71, është caktuar Qendra Shëndetësore Pustec.

Prefekti i qarkut Korçë me shkresën nr.3831 prot., datë 15.04.2021, i mbështetur në kërkesën e paraqitur nga bashkia Pustec dhe KZAZ nr.71, si objekt të përshtatshëm për caktimin e VNV-së së ZAZ nr. 71, referon Sallën në katin e parë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Pustec. Prefekti i qarkut, dhe KZAZ nr.71, argumentojnë se Qendra Shëndetësore është marrë në administrim dhe po përdoret nga Sektori i Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimi, si dhe për shkak të situatës covid ka mbingarkesë dhe nuk mund të vihet në dispozicion.

Ambienti i propozuar, për caktimin e VNV-së, sipas prefektit të qarkut dhe KZAZ-së nr.71, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. ZAZ nr. 71 ka 7 QV, plotëson kriteret



teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr.3, datë 9.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 93, paragrafi 1, dhe nenin 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSA:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit nr. 148, datë 16 Mars 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Korçë, në KZAZ-në nr.71, objekti i propozuar për VNV “Qendra Shëndetësore Pustec”, zëvendësohet me, Salla kati parë, Shkolla e Mesme e Përgjithshme” Pustec.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

